



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dosturuar Prijmenut/Pradato Received/Delivery | 18.10.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org. /Unit | Nr Prot Nr Prot Prot No | Shtojcë Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKANSHICK | 6293/2022 | | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.782/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.782/2022 të datës 08.09.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ më adresë ish _____

në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.782/2022 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti tetë (8) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) për nëpunësin civil-ankuesin.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2015 në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Monitorimit të Mjedisit në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me koeficient të _____

pagës tetë (8), më datë 19.05.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes të cilës ka kërkuar që bëhet harmonizimi i koeficientit në nëntë (9) sikurse dy pozitat e tjera dhe të kompensimin i mbushjeve telefonike në mënyrë retroaktive nga vitit 2014, ndërsa më datë 16.06.2022 Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka njoftuar ankuesin që Akt Emërimi që keni ka paraparë koeficient tetë (8) dhe për çdo pakënaqësi mund të ndjekësh rrugët ligjore.

Ankuesi kundër kësaj më datë 08.09.2022 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 5217/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që në mënyrë diskriminuese nuk është paguar me koeficient nëntë (9) sikurse dy pozitat e tjera të barasvlershme dhe në mënyrë diskriminuese nuk është kompensuar për mbushjet telefonike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ndërsa më datë 15.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore në lidhje me ankesën, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5217/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 19.05.2022 nga ankuesi; Përgjigjen e datës 16.06.2022 për ankuesin nga Emailin e datës 25.06.2018, 21.06.2018 nga ankuesi për Emailin e datës 21.06.2018 nga ankuesin; Emailin e datës 20.06.2018 nga ankuesi për Emailin e datës 08.09.2022 nga ankuesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 15.09.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 31.01.2022 dhe 08.02.2021; Planin individual të punës për vitin për ankuesin për vitin 2022 dhe 2021; Konkursin e datës 27.60.2017 për Udhëheqës i Sektorit të Monitorimit të Mediumeve Mjedisore dhe Akt Emërimin e datës 01.07.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e datës 08.09.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që në mënyrë diskriminuese nuk është paguar me koeficient nëntë (9) sikurse dy pozitat e tjera të barasvlershme dhe në mënyrë diskriminuese nuk është kompensuar për mbushjet telefonike, duke kërkuar nga Këshilli që të aprovojë ankesën dhe të obligoj organin e punësimit që të harmonizoj koeficientin nga tetë (8) në koeficientin nëntë (9) në mënyrë retroaktive nga vitit 2014 dhe dhënien e mbushjeve elektronike prej 20 euro në muaj.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për harmonizim të koeficientit, kolegji ka konstatuar se në bazë të Shtojcës Nr.1/7 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e

Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo pozitë është e barasvlershme me Udhëheqësin e Divizionit (Sektorin) në Agjenci Ekzekutive dhe se edhe katalogu i vendeve të punës ka përcaktuar pozitën Udhëheqës i Sektorit... Drejtues i Ulët 2, koeficienti i pagës është 8.5.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar edhe provat tjera materiale të lëndës, respektivisht shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, përmes të cilës shkresë DASHC kishte kërkuar nga udhëheqësit e organizatave buxhetore që të harmonizohet koeficienti i pagës për disa pozita të punës, ku ndër të tjera është kërkuar që koeficienti i pagës për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* të vendoset koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5), po ashtu me Qarkoren Administrative Nr.01/2015 të datës 24.02.2015 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike për Sekretarët e Përgjithshëm, Kryetarët e Komunave dhe Drejtorët e Përgjithshëm përmes të cilës ka kërkuar që të zbatohet Katalogu i Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës i miratuar me Vendimin me Nr. 05/12 të datës 05.02.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi mban pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit*, për të cilat pozita organi përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) kishte vendosur koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5), dhe në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e punës, gjegjësisht harmonizimin e koeficientit të pagës nga tetë (8) në nëntë (9) nuk mund të realizohet por ankuesit duhet ti rregullohet në procedura siç e përcakton legjislacioni përkatës ashtu që koeficienti i pagës të jetë tetë pikë pesë (8.5).

Kështu që duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipër cekura dhe më qëllim të respektimit të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore që koeficienti i ankuesit të harmonizohet nga tetë (8) në tetë pikë pesë (8.5), ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit për vendosjen e koeficientit të pagës nëntë (9) nuk ka mbështetje në legjislacionin e shërbimit civil me të cilat rregullohet çështja e pagave të zyrtarëve publikë, ashtu sikurse nuk ka mbështetje as në politikat e nënshkruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, si organ përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës, dhe në këtë kuptim vendosi për refuzimin e këtij pretendimi ankimor si të pa bazuar, po ashtu të pabazuar janë edhe pretendimet ankimore të ankuesit që ky harmonizim të bëhet nga vitit 2014, sepse ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim në pajtim me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor për mbushje telefonike, Kolegji i Këshillit, ka analizuar Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2008 për Përdorimin e Telefonave (Fiks dhe Mobil) në



Qeverinë e Kosovës, i cili në nenin 1, ka përcaktuar për përdorimin e rregullt dhe efikas të telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës përmes rregullimit normativ të shumës së shpenzimeve..., ndërsa neni 3 i këtij udhëzimi ka përcaktuar se kush ka të drejta për mbushje të telefonit mobil, duke përcaktuar se: "Të drejtë për mbushje të telefonit mobil kanë: këshilltarët politik të Kryeministrit, këshilltarët politik të zëvendëskryeministrave, këshilltarët politik të ministrave, këshilltarët politikë të zëvendësministrave, Shefi i Kabinetit të zëvendëskryeministrit dhe shefat e kabineteve të ministrave, Sekretarët e përgjithshëm të ministrive, Kryeshefat ekzekutiv të agjencive, drejtorët e zyrave të ZKM-së, drejtorët e departamenteve, zv.drejtorët e departamenteve, udhëheqësit e sekretariateve, koordinatorët e njësiteve dhe zyrave si dhe udhëheqësit më të lartë të shërbimit civil të organizatat buxhetore", rrjedhimit sipas Kolegjit të Këshillit, ky udhëzim administrativ nuk përcakton që Udhëheqësit e Sektorëve kanë të drejtë në mbushje të telefonit, mbi këtë bazë edhe pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Nga të lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është i obliguar që të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti tetë (8) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) për nëpunësin civil ankuesin.

Andaj, bazuar në at që u potencue më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.782/2022, datë 18/10/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.